

29 dhjetor 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA
Përmbledhje 2014 e monitorimit të urbanizmit të Prishtinës:
Vit i nismave të mira të mbetura në tentativë

Në mars të këtij viti, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Komuna e Prishtinës dhe OJQ EC Ma Ndryshe zyrtarizuan bashkëpunimin me nënshkrimin e një memorandumi të mirëkuptimit, përmes të cilit, mes tjerash u zotuan që të jenë partnerë strategjik në zbatimin e projektit “Transparenca Online e komunës së Prishtinës”, duke vepruar në transparencë të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë të ndërsjelltë.

Komponenta themelore e këtij projekti në komunën e Prishtinës është monitorimi i punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Me këtë projekt synohet ngritja e nivelit të transparencës lokale në vendimmarrje përmes monitorimit të ekzekutivit të komunave dhe raportimin për praktikën e vendimmarrjes lokale. Pjesë e projektit është edhe asistenca teknike për vendosjen e rendit urbanistik në Prishtinë.

Dy shtyllat kryesore të monitorimit të drejtorisë së urbanizmit janë çështjet që lidhen me urbanizmin dhe me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e Prishtinës. Ndërsa, aktivitetet e monitorimit gjatë këtij viti përfshinë pjesëmarrjen në cilësinë e monitorimit në takimet e Asemblesë Komunale, në Drejtorinë e Urbanizmit, bordit të drejtorëve të Komunës së Prishtinës, pjesëmarrjen në diskutimet publike rreth çështjeve urbanistike në komunë, si edhe hulumtimin e çështjeve që ndërlidhen me rendin urbanistik në përgjithësi dhe parregullsitë urbanistike, zaptimet e hapësirës urbane, statusin ligjor të qendrës historike të Prishtinës në përgjithësi dhe punët konservuese të disa ndërtesave nën mbrojtje brenda kësaj zone në veçanti.

Më poshtë po i përmbledhim disa nga të gjeturat të dalta gjatë procesit të monitorimit të Urbanizmit të Prishtinës si dhe rekomandimet kryesore.

1. *Në mars të këtij viti, EC Ma Ndryshe konstatoi se është një numër i madh i lagjeve të Prishtinës që kanë rregulluesë të skaduara (gjithsejt 8 sosh) por janë edhe shumë lagje të tjera që posedojnë plane detaje të viteve të '70 dhe '80 të shekullit të kaluar, e që s'janë reviduar asnjëherë. Një nga këto lagje është edhe qendra historike e Prishtinës, e cila për shkak të kësaj vuan nga degradimi urbanistik që prej 15 vitesh.*
- Meqë asokohe ishin duke u punuar rregulloret e reja nga ligji për Planifikim Hapësinor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, EC Ma Ndryshe, mes tjerash i rekomandoi Drejtorisë së Urbanizmit që sapo të kryhej ky proces, të nis rishqyrtimin e menjëhershëm të planeve rregulluese të skaduara, por edhe të nis procedurat e rishikimit/hartimit të planeve të reja për lagjet e Prishtinës në të cilat janë në fuqi planeve detaje urbanistike që nga vitet '70 dhe '80 të shekullit të kaluar.

- Nga informatat e fundit që kemi pasur nga Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, del se ka pasur zhvillim në drejtim të rishqyrtimit të planeve rregulluese të skaduara dhe hartimin e planeve të reja detaje urbanistike. Tashmë janë 4 lagje të Prishtinës, që kishin plane të skaduara e që janë në proces të rishqyrtimit, si dhe është marrë vendim për hartimin e planeve të reja detaje për dy lagje të Prishtinës.
2. *Diskutimet publike për planet urbane të organizuara nga Komuna e Prishtinës nuk janë gjithëpërfshirëse. Këtë e vërejtë EC Ma Ndryshe gjatë pjesëmarrjes në cilësinë e monitoruesit në disa nga këto diskutimet publike rreth planeve urbanistike. Mënyra e njoftimit të qytetarëve dhe targetimi jogjithëpërfshirës i grupeve të komunitetit ka prodhuar diskutime publike me mbi 90% pjesëmarrës të gjinisë mashkullore.*
- Përfshirja e të gjitha grupeve të komunitetit në procesin e hartimit të planeve urbane është kusht elementar i qeverisjes demokratike. Andaj, EC Ma Ndryshe i rekomandoi Komunës së Prishtinës, që ky proces, mes tjerash, të krijojë hapësirë për grupet e komunitetit që jetojnë të privuar nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike, me qëllim të rritjes cilësore të pjesëmarrjes qytetare në hartimin e planeve urbane. Po ashtu, Komunës iu rekomandua që të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile për organizimin dhe fasilitimin e diskutimeve publike; të përmirësojë mënyrën e informimit të qytetarëve rreth mbajtjes së këtyre diskutimeve.
 - Diskutimet publike të zhvillohen në grupe të vogla (15-20 vetë) brenda grupeve të caktuara të komunitetit, brenda së cilave komponenta e bazisë gjinore dhe e qasja për personat me nevoja të veçanta të konsiderohen si prioritete.
3. *Trotuaret e Prishtinës vazhdojnë të jenë të zaptuara në shkallë të madhe. Ky fakt doli në pah, gjatë një hulumtim të shkurtër në lidhje me problemet me të cilat përballën përditë këmbësorët e Prishtinës, të cilin EC Ma Ndryshe e kreu në nëntor të këtij viti. Me rezultatet e mbledhura gjatë këtij hulumtimi, EC Ma Ndryshe punoi hartat në të cilat shënohen pengesat e evidentuara në rrugët e investiguara, si dhe ato më karakteristiket ilustrohen me fotografi. Këto harta mund t'i gjeni në vegëzën: <http://ecmandryshe.org/?page=1,17,267>*
- EC Ma Ndryshe ftoi Inspektoratin e Komunës së Prishtinës që të ndërmarrë masa konkrete për largimin e të gjitha pengesave si dhe lirin e trotuarëve për shfrytëzim të qytetarëve.
4. *EC Ma Ndryshe publikoi dëshmitë shtesë të kaosit urban në qytetin e Prishtinës, përmes dokumentimit të parregullsive në lagjet Tophane dhe Dardania. Për t'u vënë në pah parregullsitë urbane është përdorur një metodologji hartëzimi për skanimin e ndërtimeve në terren, dhe identifikimin e regjistrimin e shkeljeve ndërtimore. Hartën e kaosit urban për këto dy lagje mund ta gjeni në linkun: <http://ecmandryshe.org/?page=1,17,269>.*
- Kjo hartë vuri në pah problemet themelore të moskoordinimit institucional që i kanë dhënë hapësirë veprimeve degraduese ndaj strukturës urbane të qytetit të Prishtinës. Edhe pas 15 vjetësh, Komuna e Prishtinës, nuk ka informata themelore për fondin e ndërtimeve në qytet. Si pasojë e dokumentacionit të pasistemuar urbanistik, kadastral, të pronës dhe të tjera, pamundësohet edhe evidentimi real i shkallës së degardimit

urban të qytetit. Pamundësia për të evidentuar gjendjen aktuale të ndërtimeve në qytet e ka shndërruar Prishtinën në terren të përshtatshëm për shkelje të vazhdueshme.

5. *Në ndërlidhje me ligjin për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje, i cili prej shkurtit të këtij viti ka hyrë në fuqi, dhe me shqetësim të veçantë në lidhje me trajtimin e ndërtimeve pa leje përbrenda zonave të mbrojtura, EC Ma Ndryshe ka punuar një hartë ku ka evidentuar zona të mbrojtura në qendrën historike të Prishtinës, bazuar në Ligjin për Trashëgiminë dhe listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohëshme. Kjo hartë tregon të gjitha ndërtesat në qytetin e Prishtinës që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme, si dhe perimetrin prej 50 metrash (bazuar në ligjin në fuqi për Trashëgiminë Kulturore) që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve.*

- Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të trajtimit të ndërtimeve pa leje, u rekomandojmë të gjitha komunave që në koordinim të plotë me MMPH-në dhe MKRS-në, të hartojnë harta të tilla apo të ngjashme zonale. Hartën zonale për qytetin e Prishtinës të përgatitur nga EC Ma Ndryshe, e gjeni në vegëzën www.online-transparency.org.

6. *Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit, është raporti hulumtues, të cilin EC Ma Ndryshe e publikoi në fillim të tetorit të këtij viti. Ky raport nxorri në pah shkallën e degradimit të saj, aktivitetet e dëmshme në të dhe ngriti shqetësimin për të ardhmen e saj. Në raport u numëruan disa nga problemet që e sollën “qendrën historike” të Prishtinës në atë gjendje. Në raport, mes tjerash, veçanërisht vihen në pah problemet që ndërlidhen me kufijtë e padefinuar të qendrës historike dhe mbrojtja ligjore e munguar. Nga të gjitha zhvillimet, këto probleme rezultojnë të jenë ndër më kritiket dhe që lënë më së shumti hapësirë për vazhdimin e degradimit të saj.*

- EC Ma Ndryshe rekomandoi që të ndërpriten përkohësisht të gjitha aktivitetet ndërtimore në “Qendrën historike” të Prishtinës; të zbatohen masat ndëshkuese për veprimtaritë dëmtuese dhe shkatërruese nga ana e organeve përgjegjëse; të përshpejtohet procesi i përcaktimit të kufijve të zonës historike të Prishtinës përmes grupit punues të përbashkët që tashmë është themeluar dhe funksionalizuar nga MKRS-ja; të futen në mbrojtje të përhershme ndërtesat dhe tërësitë që tash gjenden në listën e mbrojtjes së përkohëshme; të përcaktohen kufijt dhe t’i jepet status ligjor i zonës së mbrojtur “Qendrës historike” të Prishtinës dhe të procedohet me hartimin e planit të konservimit dhe më pastaj me planin e menaxhimit të kësaj zone.

- EC Ma Ndryshe është në përcjellje të vazhdueshme të çështjeve që ndërlidhen me qendrën historike të Prishtinës, dhe së fundmi, informatat që vijnë nga MKRS-ja tregojnë se ka pasur një zhvillim i vogël në këtë drejtim. Grupi punues i themeluar nga MKRS-së, i përbërë nga përfaqësues të MKRS-së, MMPH-së, Komunës së Prishtinës, IMMK-së, QRKT-së në Prishtinë, CHWB-së dhe UP-së tashmë është takuar disa herë, edhe se është në proces e sipër të grumbullimit dhe analizës së dokumentacionit rreth qendrës historike. Ky grup punues, edhe pse nuk dihet ende nëse do të ketë anëtarë shtesë në formacionin aktual, si dhe nëse do të veprojë i vetëm apo me ndihmën e nëngrupeve të tjera, prioritet do ta ketë përcaktimin e kufijve të qendrës historike të Prishtinës.

7. *As këtë vit nuk përfundon restaurimi i Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë. Lënia e objektit në gjendjen aktuale kontribuon në degradimin e tij.*
- Andaj, EC Ma Ndryshe i bëri ftesë institucioneve relevante që të reagojnë sa më shpejtë për të siguruar mjetet e nevojshme për përfundimin e projektit. Koordinimi jo i mirë mes institucioneve dhe mungesa e një plani të mirëfilltë dinamik të punëve kanë prodhuar situatën aktuale, që po e vuan Xhamia e Çarshisë dhe jo vetëm.
8. *Në fund të shtatorit të këtij viti, EC Ma Ndryshe përmbledhi problemet e vazhdueshme me të cilat po përballlet procesi i punëve konservuese të Hamamit të Madh të Prishtinës, prej fillimit i zbatimit të projektit të restaurimit në vitin 2009 e deri më sot. Janë të tri fazat e punëve konservuese që janë përcjellur me probleme të shumta, prej parregullësive në zbatimin e punëve nga kompanitë e kontraktuara, devijimet nga projekti si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes adekuate nga IMM-kja dhe Komuna, moskoordinimi ndër-institucional të MKRS-së dhe Komunës së Prishtinës, përgjegjësi e përbashkët e të cilëve ishte ky projekt, punët që bëheshin në kundërshtim të ligjit për Trashëgimi të Kosovës dhe normat profesionale të punëve restauruese në përgjithësi, etj. Kjo çoi në ndërprerje e zvarritje të shumta që dukshëm kontribuojnë në degradimin e mëtutjeshëm të ndërtesës së Hamamit të Madh.*
- Andaj, EC Ma Ndryshe rekomandoi që të krijohet sa më shpejtë një komision vlerësues nga Drejtoria e Kulturës në Komunën e Prishtinës që të vlerësohet dëmi nga veprimet jo profesionale në ndërtesën e Hamamit si dhe që të ndërmerren masat të nevojshme varësisht nga rezultatet e vlerësimit të punëve që janë kryer deri tani.
9. *Në vazhden e hulumtimit të punëve konservuese dhe restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore në Prishtinë, EC Ma Ndryshe hulumtoi arsyet e zvarritjes tre vjeçare (që nga shtatorit 2011) të fillimit të restaurimit të Xhamisë së Jashar Pashës në Prishtinë. Ky është projekt që financohet nga agjencia turke TIKa, të cilës po ashtu i është dhënë përgjegjësia e plotë e hartimit, administrimit dhe implementimit të projektit të restaurimit. Në vitin 2012, Bashkësia Islame mbylli xhaminë për besimtarë meqë ajo përbënte rrezik për shkak të problemeve strukturale që i kishte. Iu deshtën 3 vjet TIKa-s që të niste punët e restaurimit, në ndërkohë që nuk ishin ndërmarrë masa të sigurimit të objektit, dhe kishte rrezik të ishte pre e dëmtimeve nga qytetarë të pandërgjegjshëm. Një zvarritje e tillë e nisjes së punëve restauruese kontribuon në degradimin e mëtutjeshëm të ndërtesës së Xhamisë së Jashar Pashës.*
- EC Ma Ndryshe, mes tjerash i rekomandoi MKRS-së që t'i kushtojë rëndësi afateve kohore të punëve restauruese dhe konservuese, për të evituar vonesat e këtij lloji, sa herë që nënshkruan marrëveshje për punë konservuese për trashëgiminë kulturore.

Urbanizmi dhe trashëgimia kulturore po kthehen në vëmendjen e qeverisë lokale të Prishtinës. Pas viteve të gjata të neglizhencës dhe si pasojë akumulimit të problemeve, këto dy sfera të politikave publike janë trajtuar më seriozisht gjatë vitit 2014. Komuna e Prishtinës ka shfaqur interesim për mbulimin e territorit të komunës me plane urbane, përfshi edhe rishikimin e planeve të vjetra. Në anën tjetër, me ministrinë përkatëse të linjës, komuna po i zhvillon dy procese të rëndësishme, legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe trajtimin e Qendrës Historike të Prishtinës. Në raport me hapësirën publike, komuna është treguar e vendosur për të vepruar në

disa raste, ndërsa ka treguar se po zhvillon një plan të përgjithshëm për trajtimin e të gjitha hapësirave publike në qytet, me fokus në trotuaret.

Në sferat e monitoruara nga EC Ma Ndryshe komuna e Prishtinës ende nuk ka ofruar zgjidhje përfundimtare dhe të qëndrueshme. Viti 2014 ka qenë vit i vullnetit të deklaruar dhe nismave të mira të mbetura në tentativë për të vendosur rend urbanistik në komunë. Viti 2015 duhet të jetë vendimtar për fatin urbanistik të Prishtinës, si dhe për të kuptuar vendosmërinë e komunës për të jetësuar premtimin për një qytet (komunë) më të mirë. Gjatë vitit të ardhshëm, legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe trajtimi i Qendrës Historike, bashkë me rishikimin dhe hartimin e planeve urbane, duhet të sjellin ndryshime të dukshme në strukturën urbane të qytetit. Për t'u siguruar që komuna e Prishtinës do t'i jetësojë premtimet në urbanizëm dhe trashëgimi kulturore, EC Ma Ndryshe do të vazhdojë me aktivitetin monitorues dhe përkujtues edhe gjatë vitit 2015.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit të komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit,

ark. Rozafa Basha, koordinatorë e projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren

Rr. Perandori Dioklecian 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

rozafa.basha@ecmandryshe.org



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.